

## **MARRËVESHJE**

Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Austrisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Udhëtarëve si shërbim i rregullt dhe jo i rregullt

## HYRJE

Qeveria e Republikës së Austrisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, të quajtura në vazhdim si palë kontraktuese,

NË NDËRGJEGJE të vendimeve të Konferencës së Tretë Panevropiane të Ministrave të Transportit në qershor të vitit 1997 në Helsinki që të merren masa për sigurimin dhe rritjen e sigurisë së transportit rrugor dhe në transportin rrugor të udhëtarëve,

TË VENDOSUR për të përdorur me qëllim të zbatimit të synimit të një niveli të lartë mbrojtjeje të ambientit, gjithmonë duke përdorur teknologjitë më të reja sipas gjendjes teknike – veçanërisht për sa i përket zvogëlimit të emisioneve të gazrave dhe të zhurmës të dëmshme si edhe garantimit të një standarti të lartë të teknikës së sigurisë –,

NË PËRPJEKJE të rregullojnë transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve si shërbime të rregullta dhe jo të rregullta ndërmjet vendeve të tyre në këtë mënyrë si edhe të lehtësojnë organizimin dhe zbatimin e tij duke dhënë edhe një kontribut për nxitjen e turizmit dhe të të kuptuarit reciprok ndërmjet popujve në Evropë u pajtuan si në vijim:

## PJESA I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Fusha e aplikimit

- (1) Marrëveshja aplikohet për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve **jo të rregullt** (transport i rastit, transport vajtje-ardhje ndërmjet dy pikave) ndërmjet territoreve të palëve kontraktuese si edhe në tranzit nëpër territoret e tyre me mjete të lejuara për qarkullimin në një të dyja palëve kontraktuese.
- (2) Marrëveshja aplikohet për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve **të rregullt** ndërmjet territoreve të palëve kontraktuese si dhe tranzit nëpër territoret e tyre me mjete të lejuara për qarkullimin në një të dyja palëve kontraktuese.

### Neni 2 Definicionet

Në kuptim të kësaj marrëveshjeje vlejné përcaktimet e mëposhtme:

- (1) „Transporti i rastit“ është një shërbim transporti që nuk i përshtatet as përcaktimit të transportit të rregullt (paragrafi 3) as përcaktimit të transportit vajtje-ardhje ndërmjet dy pikave (paragrafi 2).
- (2) a) „Transporti vajtje-ardhje ndërmjet dy pikave“ është një shërbim transporti në të cilin transportohen në shumë udhëtime vajtje-ardhje nga e njëjta zonë nisjeje për të njëjtin destinacion udhëtarë që përpara janë bashkuar në grupe. Këta udhëtarë janë ose shtetas të njëjës prej palëve kontraktuese në të cilën mjeti me të cilin zbatohet transporti është i lejuar për qarkullimin ose shtetas të një shteti të tretë. Çdo grup udhëtarësh që ka kryer së bashku vajtjen do të transportohet në një udhëtim të mëvonshëm së bashku përsëri për në vendin e nisjes.
- b) Me „vendin e nisjes“ dhe „destinacionin“ kuptohen vendi i nisjes së udhëtimit dhe vendi i destinacionit të udhëtimit si edhe vendbanimet në një rrethinë prej 50 km. Jashtë vendit të nisjes dhe destinacionit mund të hypin ose të zbresin grupe në jo më shumë se tre pika të ndryshme.

- (3) „Transporti i rregult“ është një transport udhëtarësh me mjete me një orar të caktuar dhe tarifa të autorizuara në një itinerar të caktuar transporti me autobusa në të cilët udhëtarët mund të hypin dhe nga të cilët mund të zbresin në stacione të përcaktuara paraprakishtë.
- (4) „Transporti tranzit“ është një transport i rregullt që fillon ose përfundon mbi territorin e njërës prej palëve kontraktuese dhe kalon territorin e palës tjetër kontraktuese pa marrë ose zbritur udhëtarë, duke përfunduar ose filluar në territorin e një shteti të tretë;
- (5) "Operatori i Transportit" është çdo person fizik ose juridik që ka selinë në territorin e palës kontraktuese përkatëse dhe është i autorizuar për transportimin komercial të udhëtarëve nëpërmjet transportit rrugor.
- (6) "Autobus" është çdo automjet që
  - a) është i lejuar mbi territorin e njërës prej palëve kontraktuese për qarkullimin dhe
  - b) sipas konstruksionit dhe pajisjes së tij është i destinuar për të transportuar më shumë se nëntë persona (duke përfshirë shoferin).
- (7) "Autorizimi" është dëshmia se operatori i transportit, plotëson kushtet e nevojshme që i japin të drejtë për të kryer shërbimet e transportit të përmendura në nënin 1, paragrafi 1, të kësaj marrëveshjeje.
- (8) "Leja/koncesioni" është autorizimi i dhënë nga ana e autoriteteve që lëshohet nga secila prej palëve kontraktuese në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për pjesën e itinerarit që kalon nëpër territorin e saj dhe që i jep operatori i transportit gjatë kohëzgjatjes së saj (së tij) të drejtën e kryerjes së një transporti të rregullt të caktuar ndërmjet territoreve të të dyja palëve kontraktuese ose në transportin tranzit mbi territoret e tyre.
- (9) "Autoritetet kompetente" që përgjigjen për zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë nga ana e Republikës së Austrisë: Ministri Federal i Transportit, Inovacionit dhe Teknologjisë, për Republikën e Kosovës: Ministri i Infrastrukturës.

## **PJESA II DISPOZITAT E VEÇANTA**

### **A. TRANSPORTI JO I RREGULLT I UDHËTARËVE**

#### **Neni 3 Transportet e rastit**

- (1) Transporti i rastit në kuptim të nenit 1, paragrafi 1, të kësaj marrëveshjeje përfshin
  - a) udhëtimet qarkore me dyer të mbyllura, d. m. th. udhëtime që kryhen me të njëjtin mjet që transporton gjatë të gjithë itinerarit të udhëtimit të njëjtin grup udhëtarësh dhe e kthen në vendin e nisjes
  - b) shërbimet e transportit në të cilat pranohen udhëtarë në vajtje, kurse kthimi është një udhëtim i zbrazët (udhëtime për të dërguar udhëtarët në një destinacion të caktuar)
  - c) shërbimet e transportit në të cilat vajtja është një udhëtim i zbrazët, kurse të gjithë udhëtarët merren në të njëjtin vend pasi janë dërguar më përpara nga e njëjti operator transporti në territorin e palës kontraktuese tek e cila merren përsëri për t'u rikthyer në territorin e palës kontraktuese në të cilën mjeti është i lejuar për qarkullimin (udhëtime për marrjen e udhëtarëve)
  - d) të gjitha shërbimet e tjera të transportit të rastit
- (2) Në rast se në transportin e rastit nuk lejohet as të merren e as të zbriten udhëtarë gjatë rrugës me përjashtim kur autoriteti kompetent i palës kontraktuese në fjalë ka lejuar atë. Këto udhëtime lejohet të kryhen me një frekuencë të ndryshme pa humbur cilësinë e transportit të rastit .

#### **Neni 4 Transportet vajtje-ardhje ndërmjet dy pikave**

- (1) Në rast të udhëtimeve vajtje-ardhje ndërmjet dy pikave nuk lejohet as të merren as të zbriten udhëtarë gjatë rrugës.
- (2) Kthimi i parë dhe vajtja e fundit në rradhën e udhëtimeve vajtje-ardhje ndërmjet dy pikave janë udhëtime të zbrazëta.
- (3) Në bazë të një marrëveshjeje paraprake ndërmjet palëve kontraktuese lejohet që udhëtarët

- a) të kryejnë, ndryshe nga neni 2, paragrafi 2, i kësaj marrëveshjeje, kthimin me një grup tjetër;
  - b) të merren ose të zbriten, ndryshe nga neni 4, paragrafi 1, i kësaj marrëveshjeje, gjatë rrugës.
- (4) Me një grup udhëtarësh të formuar paraprakisht kuptohet një grup për të cilin një person ose organ përgjegjës sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi, të njërës prej palëve kontraktuese ka marrë përsipër lidhjen e kontratës ose zbatimin e shërbimit të transportit.

## **Neni 5**

### **Nevoja e autorizimit**

- (1) Për shërbimet e transportit të kryera sipas nenit 1, paragrafi 1, të kësaj marrëveshjeje parimisht nevojitet një autorizim i palës kontraktuese për territorin e së cilës kryhet transporti i udhëtarëve në qoftë se neni 6 i kësaj marrëveshjeje nuk e përcakton ndryshe.
- (2) Autorizimet janë të vlefshme brenda një viti kalendarik dhe muajit që vijon menjëherë pas këtij (janarit), me përjashtim të rasteve kur caktohet ndryshe në kuadër të Komisionit të Përbashkët (neni 17).
- (3) Autorizimi duhet të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme:
- a) emrin (firmën) dhe selinë e operatorit
  - b) targën e mjetit/targat e mjeteve,
  - c) emrin dhe mbiemrin e shoferit/e shoferave,
  - d) itinerarin (duke përmendur pikat e kalimit të kufirit),
  - e) fillimin dhe mbarimin e udhëtimit (vendin dhe datën).
- (4) Forma më e saktë dhe përmbajtja e autorizimit përcaktohen nga Komisioni i Përbashkët (neni 17).
- (5) Autorizimi vlen pa përjashtim për operatorin e transportit, në emrin e të cilit është lëshuar dhe nuk është i tjetërsueshëm. Autorizimet u dorëzohen nga autoritetet kompetente të njërës prej palëve kontraktuese autoriteteve kompetente të palës tjetër kontraktuese, e cila i jep të plotësuar operatorit që vjen në konsideratë. Të dhënat sipas nenit 5, paragrafi 3, shkronjat b deri e, të kësaj marrëveshjeje duhet të plotësohen nga vetë operatori i transportit.

## **Neni 6**

### **Transporti për të cilin nuk nevojitet autorizim**

- (1) Shërbimet e transportit të përmendura më poshtë mund të kryhen pa patur nevojë për një autorizim nëse mjete me të cilin bëhet transportimi ka një gjendje teknike të lartë për sa u përket lirit të gazrave dhe standartit teknik të sigurisë:
  - a) udhëtimet qarkore me dyer të mbyllura sipas nenit 3, paragrafi 1, shkronja a, e kësaj marrëveshjeje
  - b) shërbimet e transportit sipas nenit 3, paragrafi 1, shkronja b
  - c) shërbimet e transportit sipas nenit 3, paragrafi 1, shkronja c
- (2) Gjendja teknike përkatëse në fuqi në kuptim të paragrafit 1 si edhe dëshmia e vlefshme përcaktohet nga Komisioni i Përbashkët (neni 17).
- (3) Përveç kësaj palët kontraktuese mund të pajtohen, sidomos me propozimin e Komisionit të Përbashkët (neni 17), për shërbime të tjera të transportit që mund të kryhen pa patur nevojë për autorizim.

## **Neni 7**

### **Dokumentat e nevojshme**

- (1) Dokumentat e mëposhtme të plotësuara duhet të mbahen në automjet gjatë gjithë udhëtimit dhe duhet të paraqiten kur kërkohen nga ana e organeve të kontrollit:
  - a) një dokument kontrolli për transport të rastit të udhëtarëve
  - b) një autorizim sipas nenit 5ose
  - c) një dëshmi sipas nenit 6, paragrafi 2
- (2) Dokumenti i kontrollit dhe dëshmia sipas nenit 6, paragrafi 2, lëshohen nga autoritetet kompetente të palës kontraktuese përkatëse ku mjete është i lejuar për qarkullimin ose nga një organ tjetër i autorizuar për të.
- (3) Forma dhe përmbajtja e dokumentit të kontrollit dhe e dëshmisë sipas nenit 6, paragrafi 2, përcaktohen nga Komisioni i Përbashkët (neni 17).

## **Neni 8**

### **Kontingjentet**

Për numrin e autorizimeve vjetore (kontingjentet) dhe datën e dorëzimit merren vesh gjithmonë për 1 vit kalendarik autoritetet kompetente të palëve kontraktuese në bazë të propozimit të Komisionit të Përbashkët (neni 17).



## B. TRANSPORTI I RREGULLT I UDHËTARËVE

### Neni 9 Leja /koncesioni

- (1) Një transport i rregullt ndërkombëtar mund të kryhet vetëm në bazë të lejeve/koncesioneve të autoriteteve kompetente të të dyja palëve kontraktuese si dhe të lejeve të shteteve të treta të prekura.
- (2) Kërkesa për marrjen e një leje/koncesioni duhet t'i drejtohet autoritetit kompetent të vendit të themelimit të operatorit të transportit. Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:
  - emrin dhe adresën e operatorit të transportit,
  - itinerarin,
  - një skicë të itinerarit,
  - çmimet e transportit,
  - një projekt orari (duke përmendur të gjitha stacionet si edhe pikat e kalimit të kufirit),
  - periudhën e parashikuar të operimit,
  - fillimin e synuar të operimit si edhe
  - të dhëna mbi numrin, tipin e konstruksionit dhe pajisjen e autobusave (veçanërisht përmasat dhe peshën maksimale të përgjithshme të lejuar që do të përdoren.

Autoriteti i themelimit i dërgon autoritetit kompetent të palës tjetër kontraktuese një ekzemplar të kërkesës për marrjen e pelqimit dhe në rast nevojë autoriteteve të shteteve të treta të prekura nga transporti i synuar me linjë. Më këtë vërteton besueshmërinë, kapacitetin financiar dhe aftësinë profesionale të operatorit të transportit.

- (3) Pas marrjes së pelqimit për vendosjen e linjës duke ruajtur reciprocitetin parimor dhe kur ekziston edhe miratimi i shteteve të tjera të prekura, autoritetet kompetente japin lejet (koncesionet), i shkëmbejnë dhe u dërgojnë autoriteteve të shteteve të tjera të prekura një kopje. Sipas parimit të reciprocitetit duhet, në rast të dhënies së një autorizimi për një operator të transportit të njëjës prej palëve kontraktuese, t'i jepet një leje (koncesion) për të njëjtën linjë dhe në të njëjtat kushte edhe një operator të transportit të përshtatshëm të propozuar nga autoriteti kompetent i palës tjetër kontraktuese.

- (4) Lejet /koncesionet lëshohen për një kohëzgjatje maksimale prej 5-vitesh dhe shkëmbehen nga autoritetet në dy ekzemplarë. Njërën prej këtyre ekzemplarëve e merr paraqitësi i kërkesës bashkë me lejen (koncesionin) e lëshuar nga autoriteti i themelimit të tij.
- (5) Në rast të kalimit të kufirit për në Republikën e Austrisë origjinali i njërës prej dokumenteve të koncesionit (blu) i paraqitet autoritetit kompetent austriak dhe në rast të kalimit të kufirit për në Republikën e Kosovës origjinali i lejes duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent kosovar. Në bazë të një kërkesë autoritetet kompetente lëshojnë më shumë ekzemplarë të njëjtë të dokumentit të koncesionit dhe të lejes sa të nevojiten për plotësimin e programit të operimit të transportit të rregullt. Në varesi nga kapacitetet disponuse.
- (6) Nga që Republika e Austrisë dhe Republika e Kosovës nuk kanë kufi të përbashkët, ushtrimi i koncesioneve të dhëna në mënyrë reciproke varet nga kushti nëse edhe autoritetet kompetente të shteteve të treta ku operatori i transportit kalon tranzit japin autorizimet e nevojshme ligjore. Perjashtimish nga kjo komisioni i përbashkët i ngritur sipas kesaj marrveshje mundë të vendos ndryshe.

## **Neni 10**

### **Transporti tranzit**

- (1) Për transportin tranzit nëpër territorin e palëve kontraktuese nevojitet gjithashtu një leje/koncesion.
- (2) Për të evituar që autoritetet kompetente të shteteve të treta t'u paraqesin autoriteteve të tjera kompetente që preken për të njëjtën linjë kërkesa të ndryshme për sa i përket itinerarit dhe paraqitësit të kërkesës merret vesh se kërkesa të tilla do të trajtohen vetëm nëse del nga letrat shoqëruese të autoriteteve kompetente të shtetit të tretë se të gjitha shtetet e prekura nga transporti i synuar kanë marrë të njëjtat kërkesa. Nëse nuk është kështu duhet të arrihet një konsensus i tillë.

## **Neni 11**

### **Rivokimi i lejes/koncesionit**

- (1) Autoriteti kompetent mund të rivokojë lejen/koncesionin sipas dispozitave ligjore kombëtare, sidomos nëse operatori i transportit nuk fillon shërbimin në kohën që i është caktuar ose nuk operon linjën në përputhje me dispozitat ligjore dhe kushtet e lejes edhe pse është paralajmëruar të paktën dy herë me shkrim.

- (2) Për një masë të tillë duhet të informohet menjëherë autoriteti kompetent i palës tjetër kontraktuese. Në rastin e revokimit të lejes (koncesionit) ky autoritet mund të propozojë një operator tjetër të transportit, të përshtatshëm për operimin e linjës.

### **Neni 12** **Oraret dhe çmimet e transportit**

- (1) Çmimet e transportimit duhet të miratohen, nëse kjo është e nevojshme sipas legjislacionit kombëtar. Oraret do të jenë të vlefshme deri në mbarim të lejes(koncesionit). Në bazë të një kërkesë përkatëse autoriteti kompetent mund të miratojë ndryshimin e orarit.
- (2) Për caktimin e çmimeve të transportimit vlen parimi i tarifës së njëjtë për operatorët e transportit që operojnë në të njëjtën linjë autobusi.
- (3) Për biletat vjatje-ardhej mundë të arrihet një marrveshje për redukimin e çmimeve.

### **Neni 13** **Njoftimi i të dhënave të operimit**

Operatori i Transportit është i detyruar ta njoftojë autoritetin e themelimit të tij deri në fund të muajit shkurt për vitin kalendarik të kaluar për:

- numrin e kilometrave të bërë,
- numrin e udhëtarëve të transportuar si edhe
- autobusat e përdorur.

Autoritetet kompetente shkëmbejnë rregullisht këto njoftime të të dhënave të operimit.

## **PJESA III DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 14 Ndalimi i kabotazhit**

Pranimi i udhëtarve në territorin e palës tjetër kontraktuese për t'i transportuar brenda këtij territori nuk është i lejueshëm.

### **Neni 15 Respektimi i dispozitave ligjore kombëtare**

Operatori i Transportit është i detyruar të respektojë gjatë operimit të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve të gjitha dispozitat ligjore kombëtare përkatëse të shtetit të themelimit të tij dhe të shtetit përkatës që kalon.

### **Neni 16 Masat në rastin e shkeljeve**

- (1) Në rastin e shkeljeve të dispozitave ligjore në fuqi mbi territorin e palës tjetër kontraktuese ose të dispozitave të kësaj marrëveshjeje nga ana e Operatorit të Transportit ose e personelit të tij që ngetë autobusat, autoriteti kompetent i palës kontraktuese në territorin e së cilës mjete është i lejuar për qarkullimin, duhet të marrë në bazë të kërkesës së autoritetit kompetent të palës tjetër kontraktuese masat e mëposhtme:
  - a) paralajmërimin e Operatorit të Transportit duke i tërhequr vëmendjen se duhet të respektojë dispozitat në fuqi dhe dispozitat e kësaj marrëveshjeje;
  - b) ndërprerjen e lëshimit të autorizimeve për transportin e rastit të udhëtarëve për transportimet nga ana e këtij operatori të transportit për në territorin e palës tjetër kontraktuese mbi të cilin u krye shkelja ose revokimi i autorizimeve të lëshuara.
  - c) Në rastin e shkeljeve të rënda ose të përsëritura të kësaj marrëveshjeje nga ana e një operatori të transportit të njërës prej palëve kontraktuese ose të personelit të tij që nget autobusat mbi territorin e palës tjetër kontraktuese autoriteti kompetent i palës tjetër kontraktuese mund të përjashtojë operatori të transportit përkatës përkohësisht ose për gjithmonë nga transporti mbi territorin e tij.
- (2) Autoritetet kompetente të të dyja palëve kontraktuese informojnë njëra-tjetrën mbi shkeljet sipas paragrafit 1 dhe mbi masat e marra.

## **Neni 17** **Komisioni i Përbashkët**

- (1) Për mbikqyrjen dhe zbatimin e rregullt të kësaj marrëveshjeje palët kontraktuese krijojnë një Komision të Përbashkët që përbëhet nga përfaqësuesit e të dyja palëve kontraktuese.
- (2) Komisioni i Përbashkët mbledhet në bazë të dëshirës së shprehur nga njëra prej të dyja palëve kontraktuese dhe merr vendime me mirëkuptim.
- (3) Nëse Komisioni i Përbashkët trajton çështje që kanë të bëjnë me sektorë të tjerë, palët kontraktuese mund të ftojnë ekspertë të tjerë nga këta sektorë të marrin pjesë në bisedime.

## **Neni 18** **Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pasi që palët kontraktuese do të kenë informuar njëra-tjetrën për mbarimin e procedurave të parashikuara nga shteti përkatës.

## **Neni 19** **Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Kjo marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje prej katër vjetësh. Vlefshmëria e saj do të zgjatet për edhe një vit, nëse nuk është denoncuar me shkrim nga njëra prej palëve kontraktuese jo më vonë se tre muaj para mbarimit të këtij afati.

E bërë në Vjenë më 21. Qershor. 2013 në dy ekzemplarë origjinalë, në gjuhën gjermane dhe shqipe, nga të cilët të dy janë njësoj autentikë.

Për Qeverinë e  
Republikës së Austrisë

**Mag. Ursula Zechner**

Për Qeverinë e  
Republikës së Kosovës

**Dr. Sabri Kiqmari**